

RELACION TEKNIK

Per urën e shkatërruar, tek Lumi i “Rëmenjit”,Lagja e “Gojakut” Remenj.

Nga kontrolli i ushtruar ne terren mbas renies të shirave të vazhdueshme , të rrëmbyeshme në datat 10 e 11.10.2015 në zonën e Bashkisë Pogradec,njësia administrative Buçimas, në urën e lumit Remenj, lagja e “Gojakut” fshati Remenj, për gjëndjen aktuale të saj ,rezulton si me poshte:

Nga shirat e rrëmbyeshme dhe prurjet tepër të shumta ura prej betoni,mbi lumin e Rëmenjit,në lagjen e “Gojakut” është shkatërruar totalisht, soleta dhe dy shpatullat e urës.Janë gërryer skarpatat në hyrje dhe dalje të urës rreth 25m. Për pasojë është pezulluar lëvizja e mjeteve dhe njerëzve ne këtë lagje.

Per sa me siper per lidhjen e rruges te lagjes duhet te ndertohet ure e re prej b/armeje, muret mbajtese ne skarpatat e lumit ne hyrje dhe ne dalje te ures.

Ura qe duhet te ndertohet eshte me hapesire drite 4.4 m, me lartesi 2.5 m nga toka me gjeresi 4.4 m,me bordure b/arme anesore dhe parmake metalike.

Në ndërtimin e themeleve të urës të kihet parasysh gjetja e tabanit të tyre, thellësia e tyre mund të shkojë dhe më tepër se ajo e parashikuar në projekt.

Para se të hidhet beton i themelit të urës të kontrollohet bazamenti nga një ing.gjeolog e të hartohet proces-verbal me ndërtuesin për vazhdimin e punimeve.

Betonet e shpatullave dhe soletës të urës të realizohen me markën e kërkuar në project e duke zbatua kushtet teknike të zbatimit në ndërtim.

Materialet inerte për betonet të jenë sipas standarteve.Mbas mureve te hidhet dhe ngjishet material shkembor .

HARTUAN

Ing. Todi Buzo

Ark. Dhimitraq Gjata